

## NJË ANALIZË HERMENEUTIKE MBI POEZINË RRESHPJANE

### Hyrje

Dikur, njohësi i thellë i Dantes, savanti dhe kritiku i madh italian De Sanktis (Sanctis), la një frazë e cila nuk do të shlyhej lehtë prej kujtesës sime:

*“Libri i poetit është gjithë universi, ndërsa libri i kritikut është poezia”<sup>1</sup>.*

Fjalë të maturamirë prej një intelektuali të madh dhe një burri fjalëpak. E në të vërtetë poezia është një “veprimtari evristike (zbuluese)” e shkallës së parë, ku poeti për t’u bërë i përbotshtëm krahas tematikës universale synon që të rrokë edhe fjalën e kulluar për shprehjen e thelbit të qenies. Si një kërkues i palodhur i të dyjave, ai bëhet kështu një shtegtar i pakufizuar në kohë dhe hapësirë, për të na zbuluar “*Natursprache-n*”<sup>\*</sup> dhe atë thellësi, qartësi dhe lartësi të shpirtërores harruar prej kaq shumë kohësh brenda nesh.

*“Poezia është gjinia më e lartë e artit. Ajo përmes një numri të kufizuar fjalësh arrin të shprehë një mori ndjenjash, mbresash dhe idesh në shkalln më të lartë estetike”<sup>2</sup>.*

Duke e gëzuar një status të tillë social ajo e tërheq edhe më tepër vëmendjen dhe interesin e kritikëve për t’u marrë me të. Nga ana tjetër, ndryshe nga një roman apo novelë ajo të ofron lehtësinë

---

<sup>1</sup> Federico Roncoroni, *Guida all’ analisi delle opera e degli autori nel loro tempo*, “Arnoldo Mondadori”, Milano 1984, f. 33.

<sup>\*</sup>Natursprache (ger) – Fjalë për fjalë: Gjuha e natyrës. Koncept i përdorur nga mistiku gjerman i shek. XVI, Jakob Bojme (Jacob Böeme), për të shënuar atë gjuhë primordiale që foli Adami për herë të parë në Kopshtin e Edenit, për të cilën ai pretendonte se i ishte dhënë dhuntia që ta kuptonte. Quhet ndryshe gjuha zanafillore ose *Lingua Adamica*.

<sup>2</sup> V.G. Belinski, *Artikuj kritikë*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977, f. 64.

dhe komoditetin që lexohet shpejt dhe përcjellja e mesazhit së bashku me emocionin është e menjëhershme. Për rrjedhojë, në poezi sopata e kritikës është edhe më e mprehtë se në çdo art tjetër, ndërsa krasitjet e saj të pamëshirëshme. Në këtë kuptim, për shkak të natyrës së saj, por edhe atij mjalti tundonjës që të tërheq pa kuptuar, poezia kthehet vetvetiu në librin qendror të kritikut. Kritiku gjithashtu, si një peshues estetik mbështetet mbi atë që poeti shtyp në letër, d.m.th. shpirtëroren e materializuar (librin), duke u orvatur sadopak që të dritësojë dhe të nxjerrë në pah ato elemente, koncepte, ide dhe korrelacione që ai i pikas brenda tekstit poetik. Sepse siç shprehet edhe profesori i Oksfordit (Oxfordit), Kristofer Riks (Christopher Ricks),

*“...kriticizmi në thelb është një diskutim i literaturës. Ai nuk është një zëvendësim i leximit të veprës letrare në vetvete. Detyra e tij është të ketë të bëjë vetëm e vetëm me ato elemente brenda veprës letrare prej të cilave mund të përfitohet konstruktivisht gjatë leximit të tyre ”.*<sup>3</sup>

Përmes leximit kritik të teksteve poetike të Rreshpes si: “Rapsodi shqiptare” (1968), “Erdhi ora të vdes përsëri” (1994), “Lirika të zgjedhura” (1996) dhe “Duke kërkuar Itakën” (2016) synojmë të ngremë bazamentet e kësaj analize hermeneutike dhe të evidentojmë influencat dhe aspektin korrelativ në veprën rreshpjane, duke u përpjekur sadopak që të vëmë një gur në njohjen e këtij poeti të madh. Nëse ia kemi dalë mbi krye kësaj pune apo jo, t’ia lëmë në dorë lexuesve të këtyre radhëve që ta vlerësojnë. *Impadivi progrediamur!*<sup>4</sup>

### **“Rapsodi shqiptare” në frymën e kohës**

Përgjithësisht, ndërsa shkruaj mbi një vepër poetike nuk interesohem më parë mbi biografinë e autorit apo të marr informacione shtesë rreth tij, pasi besimi im është që mund të përfitosh më tepër duke e shijuar personalisht poezinë, sesa nga njohuritë apo mendimi i të tjerëve mbi të. Një kredoje të tillë i kemi qëndruar besnik në leximin dhe dekonstruktimin e poezisë rreshpjane. Por, përpara se të nisim analizën, le t’ju paraprijmë

<sup>3</sup> Christopher Ricks, *Poems and Critics*, “Collins”, London, 1966, f. 9.

<sup>4</sup> Impadivi progrediamur (lat) - Le të shkojmë përpara me guxim!

keqkuptimeve dhe të theksojmë se ky dekonstruktiv në vetvete nuk është “një akt rrënues” dhe “asgjësim”, por njohje dhe thellim. Kështu që çdo tentativë apo përpjekje e ndonjë lexuesi “tepër të zellshëm” ndaj tekstit poetik rreshpjan për ta parë këtë punim si “diçka tendencioze dhe dashakeqe ndaj autorit”, shkruesi i këtyre radhëve e refuzon dhe e hedh poshtë në mënyrë kategorike. Analiza hermeneutike bëhet me kokë të ftohtë dhe jo me pathos krahinorist e zjarre dashamirësish.

Libri “Rapsodi shqiptare” është një vëllimth poetik i shkruar në vitet ‘60-të, i cili ka përgjithësisht në përmbajtjen e vet një poezi të angazhuar ideologjikisht dhe me tonet e realizmit socialist. Ku bazohemi për ta mbështetur këtë pohim? Sigurisht që në brendinë e vetë librit. Kjo vihet re që në poezinë hyrëse “Shqipni” ku autori shpërhap estetikisht të njëjtën dogmë zyrtare historike të regjimit komunist, sipas të cilës “Shqipëria e ka çarë udhën e historisë me shpatë në dorë”. L t’i hedhim një sy poezisë për ta konstatuar këtë fakt:

*“ Ti i rropose të gjitha:  
Hyjnitë e lashtë,  
Shtatoret e pluhunosuna,  
mëshirën e ungjijëve.  
Dhe mbajte vetëm shpatën...  
Vërtet,  
Ti ndryshe,  
Si do të çaje udhë ”?*<sup>5</sup>

Dy temat qendrore të trajtuara poetikisht nga autori janë ajo e heroit të rënë komunist dhe e heroit të punës socialiste. Të dyja pjesë integrale e ideologjisë së kuqe komuniste. Aspekti i parë lidhet me çlirimin si proces, ndërsa ai i dytë me ndërtimin. Duke qenë se komunistët kishin qenë pjesë e koalicionit të fitimtarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe e çliruan vendin nga nazistët, ata kishin një kartë të fortë morale në duar për të luajtur. Kështu, përmes arketipit të partizanit (“Zanit të Partisë”) ata modeluan shëmbëlltyrën e heroit të rënë për atdhe, i cili qe padyshim heroi komunist. Ky arketip u bë imperativ kategorik për t’u përdorur në çdo gjini të artit: skulpturë, pikturë, muzikë, poezi etj. (Kujto: “Pamfleti i Zhdanovit”) Si përjetues dhe gjallues i kësaj kohe, edhe Rreshpja do ta poetizonte heroin e rënë komunist. Ja

<sup>5</sup> Frederik Rreshpja, *Rapsodi shqiptare*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1968, f.3.

sesi shprehet ai në poezinë "Partizani":

*"Po lindëte...  
Retë morën udhën e horizontit;  
Po tue mbartë në sup Yllin e Mëngjesit  
Ai ngjitej lart qetë-qetë në kujtesën e kombit".<sup>6</sup>*

Një fakt tjetër që vlen të shtohet është se tema e heroit të rënë komunist për liri nuk është një temë e trajtuar veçanërisht vetëm nga poetët tanë. Duke qenë se komunizmi si çdo ideologji tjetër e madhe kishte karakter ekspansionist, ajo u trajtua poetikisht në shumë pjesë të botës ku kjo dogmë hodhi rrënjë. Shumë poetë të mëdhenj botërorë e me prirje komuniste siç qe Ricosi, Aragoni, Elyari, Hikmet apo edhe Neruda e kanë përfshirë atë në poezitë e tyre. Ricosi në veçanti, prej të cilit Rreshpja ndikohet në disa raste, është më i angazhuar mbi këtë tematikë. Ja sesi shprehet ai tek "Mëhallat e botës":

*"Përpara, përpara, për tek dielli, shokë!  
Ky popull nuk përkulet veçse përpara të vdekurve të vet".<sup>7</sup>*

Besoj është e kuptueshme që dielli në këtë distik është simbol i lirisë dhe të rënë të atdhe që populli iu përulet duke i nderuar dhe kujtuar janë diellsjellësit, shokët, komunistët. Në këtë vëllimth, Ricosin e gjejmë të ndërftuar disa herë në vargjet e Rreshpes. Le të marrim edhe një shembull tjetër për këtë pohim, poezinë "Xha Miçoja" të Ricosit. Ka një metaforë brilante aty, të farkëtuar nga forca krijuese e poetit:

*"Tre viça re po pinë ujë në postafin e hënës"<sup>8</sup>*

I ndikuar nga kjo metaforë, Rreshpja ngjiz një metaforë tjetër po kaq mbresëlënëse:

*"Brinjave të vetmueme, era ngiste me vrap buajt e reve"<sup>9</sup>*

---

<sup>6</sup> Rreshpja, po aty, f. 5.

<sup>7</sup> Janis Ricos, *Mëhallat e botës*, përktheu: Spiro Çomora, "Naim Frashëri", Tiranë, 1961, f. 93.

<sup>8</sup> Ricos, po aty, f. 12.

<sup>9</sup> Frederik Rreshpja, *Rapsodi...*, f. 66.

Tematika e dytë, ajo e heroit të punës socialiste vihet re në poezi të tilla si: “Balladë për Pjetër Lleshin”, “Hekuran-Hekuran”, “Ushtarë të revolucionit” etj. Ky hero i ndërtimit të socializmit është njeriu i thjeshtë, njeriu i vulgut ose ndryshe proletari i cili për shkak të bindjes dhe idealit jep gjithçka, madje dhe jetën në disa raste vetëm e vetëm që atdheu të ndërtohet dhe partia të lartësohet. Në këtë fazë të krijimtarisë së tij, Rreshpja shkruan çfarë ndjen dhe beson. Ai është një entuziast i lirë dhe një idealist, i cili beson te fuqia e ndryshimit dhe e ardhmja e përparuar përmes njeriut të ri socialist. Këtë bindje ai e shpalos poetikisht, në mënyrë të çiltër dhe naive. Është një fazë krijimtarie ku hovi i tij rinor i bashkohet atij të kohës dhe të dy ecin nëpër të njëjtët binarë.

Një fakt që duhet përmendur është se në poezinë shqiptare gjatë viteve 1946-1986 përgjithësisht është thuar se pamundur që të gjesh ndonjë poet që të mos ketë trajtuar poetikisht të paktën një nga dy tematikat e mësipërme ose të dyja së bashku në botimet e veta. Në frymën e kohës dhe sistemit, madje edhe shumë poetë të tjerë si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Llazar Siliqi etj do të shkruanin poezi e poema me të njëjtin kumt dhe stil të diktuar nga koha. Mjafton të kujtojmë “Shqiponjat fluturojnë lart” dhe “Nënë Shqipëri” të dy të parëve si dy medalione të arta të socio-realizmit. Në këtë libërth të të riut Rreshpja, kemi pikasur edhe disa distikë të veçantë, të cilët dëshmojnë për një individ me shkëndijë të lindur poetike dhe në zbulim të vetvetes e sipër. Ja disa prej tyre:

*“Më duket se mijëra vjet kam jetue këtu mbi tokë  
Tue lexue hieroglifet e kuqe të vetëtimave”.<sup>10</sup>*

Ose si:

*“Ku venë këto re të grisuna  
Me këto vetëtimat të thyeme mbi kurriz”.<sup>11</sup>*

E më tej:

*“Pleqtë shkoqnin nenet  
Dhe fjalët binin poshtë si të ishin krisma”.<sup>12</sup>*

<sup>10</sup> Rreshpja, Rapsodi..., f. 4.

<sup>11</sup> Rreshpja, Rapsodi..., f. 22.

<sup>12</sup> Rreshpja, Rapsodi..., f. 59.

Për ta përmbyllur me një distik surreal që na kujton paksa Pablo Nerudën:

*“Kërcen hana flokëlëshue katarakteve;  
Hidhen kataraktet të qeshun dhe ajëror”.*<sup>13</sup>

Një element tjetër përbërës të këtij liberthi, të cilin do të donim ta veçonim janë edhe lirikat e peisazhit. Megjithëse të pakta në volum krahasuar me pjesën tjetër, nuk mund t'i kalonim pa i specifikuar. Gjykojmë që në dy prej tyre vihet re muzikaliteti, stili dhe fryma poetike e lirikut të madh rus, Sergei Esenin. Poezia e parë “Mbrëmje të korrash” na jep një koktej mbresash imazhiniste me një sërë termash bukolike dhe idilike eseniniane, ndërsa poezia tjetër “Në fushat dimnore” më ngjall në kujtesë si një këngë nanuritëse poezinë “Më thonë lulet lamtumirë” të poetit rus, ku subjekt i së cilës është gjithashtu motivi i ndarjes.

Ajo që evidentojmë dhe na bën përshtypje janë përpjekjet e pareshtura të një shpirti tejet kërkues ndaj vetvetes dhe në eksplorim e sipër për gjetjen e asaj gjuhe poetike e cila ta veçojë dhe identifikojë estetikisht atë në të ardhmen. Kjo duhet shënuar si fillimi i një faze eksperimentale në krijimtarinë rreshpjane, në të cilën bën pjesë edhe ndikimi prej poezisë klasike kineze të Dinastisë Tang. Por përpara se të gjurmojmë mbi këtë ndikim, le të japim disa veçori dhe tipare të poezisë klasike kineze. Elementi kyç dhe tabani mbi të cilin ngrihet përgjithësisht poezia klasike kineze është natyra, diçka që lidhet ngushtë edhe me botëkuptimin natyralist të këtij populli për jetë-botën, ku gjithçka varet nga TAO, d.m.th. ligji i ndryshimit. Për ta ilustruar këtë fakt, po japim një distik prej poetit kinez Czhi Cin Juji:

*“Çdo gjë vjen e ikën  
E përjetshme është vetëm Natyra”.*<sup>14</sup>

Natyra gjen përdorim thuajse në shprehjen e çdolloj emocioni prej poetit kinez: të vetmisë, mallit, brengave, dashurisë, trishtimit, ndarjes (qoftë kjo e fundit miqësore apo intime), madje edhe të trazirave sociale e luftërave midis mbretërive që ishin të

<sup>13</sup> Rreshpja, Rapsodi..., f. 65.

<sup>14</sup> Poezi klasike kineze. Dinastia Tang, përktheu: Ismail Kadare, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1961, f. 168.

shpeshta në Kinën e asaj kohe. Gjithashtu, ajo zë vend edhe si element soditjeje dhe meditimi, ku subjekti dhe objekti shkrihen brenda emocionit të një çasti njësimi, fryt i së cilës është dhe “Poezia e mbresës”. Përgjithësisht ajo është një poezi e shkurtër, por me karakter deskriptiv, shumë e pasur në imazhe dhe shkalla e impresionit që përçon është mjaft e lartë. Nga përshkallëzimi i këtyre imazheve në vargun poetik përftohet një përrua emocional, i cili na merr me vete gjatë leximit dhe ndërsa mbushim çastin, pa kuptuar kemi mbërritur në fundin e saj. Por le të kthehemi tek subjekti ynë, poezia rreshpjane dhe në analogji me poezinë kineze ta evidentojmë këtë efekt. Le të marrim p.sh., poezinë e Rreshpess “Alpet”:

*“Lugina të kaltërta, ku mbijnë agimet,  
Përrenj që zbresin si kope të bardha;  
Shkrepa pleq, të menduem, të vrazhdë  
Dhe, përmbi këta,  
Buzëqeshja e kaltër e qiellit”.*<sup>15</sup>

Tani të vëmë përballë saj një pasazh poetik të shkëputur nga “Kënga V” e Du Fu-së në “Shtatë këngë të një të internuari në Tungku”:

*“Përqark rreh kodrat era,  
Ujërat rrjedhin.  
Përrenjve po breron  
Një shi i ftohtë.  
Lisat e tharë kullojnë,  
Kullojnë bredhat.  
Hedh sytë larg:  
Të verdha fushat sot”.*<sup>16</sup>

A nuk janë që të dyja poezi me përshkallëzim imazhesh natyrore dhe me të njëjtin efekt rrëmbyes mbi atë që i lexon?! “Përrenj që zbresin poshtë si kope të bardha”, - tingëllon Rreshpja. Diçka e cila na kujton paksa vargun magjik të Li Bo-së: “Notojnë qiellit larg kopera resh”<sup>17</sup>.

<sup>15</sup> Rreshpja, Rapsodi..., f. 7

<sup>16</sup> Poezi klasike kineze..., f. 112.

<sup>17</sup> Poezi klasike kineze..., f. 38.

Ato na përfshijnë me përskrimet e tyre të shkurtra dhe të shpejta. Një poezi-pikturë! Kjo më sjell ndër mend filozofin grek, Simonidin e Kosit i cili pohonte:

*"Piktura është një poezi pa zë, ndërsa poezia një pikturë që flet!"<sup>18</sup>*

Dhe në të vërtetë, në vijueshmërinë e tyre kohore poezitë rreshpjane do të transformohen rrënjësisht "*në piktura që flasin*". Këtë eksperiment me efekt të menjëhershëm te lexuesi, Rreshpja do ta aplikojë edhe në poezitë "*Liçejtë malorë*", "*Kur vërshojnë përrenjtë*" etj. Këtë do ta përsërisë edhe në krijimtarinë e mëvonshme poetike të pas viteve '90-të.

## 1.2 "Erdhi ora të vdes përsëri" dhe kthesa e madhe estetike

Diku, kritiku i madh amerikan Harold Blum (Bloom) shkruante:

*"Vetmia është elementi më i spikatur i qenies sonë. Ne lexojmë për ta populluar vetminë tonë me njerëz"<sup>19</sup>.*

Është e vërtetë që shpesh lexojmë edhe për hir të këtij akti. E ndërsa ne si lexues mundohemi sadopak që ta zbusim vetminë në këtë lloj mënyre, përkundrazi shkrimtari krijon estetikisht për t'u përballur me vetminë e papërbalueshme të qenies. Një shkrimtar i tillë është edhe poeti Frederik Rreshpja. Një "*qyqe poetike*"<sup>20</sup> me trishtim universal, që bart trishtimin e gjithësecilit prej nesh, trishtimin e njerëzve. Në një intervistë të vjetër dhënë te "*Zëri i Rinisë*", në 25 nëntor të vitit 1992 ai do të shprehej:

*"Nuk e di në më ka mbetur më ndonjë gjë që të më gëzojë... Kur trishtohem, shkruaj. Prandaj shkruaj shumë"<sup>21</sup>.*

<sup>18</sup> Hart Wegner, *Lamtumirë fjalë*, Eseistikë, përktheu: Pirro Dollani, "Ideart", Tiranë, 2006, f. 53.

<sup>19</sup> Harold Bloom, *Si dhe përse të lexojmë*, Kritikë Letrare, përktheu: Albana Sala, "Dudaj", Tiranë, 2008, f. 80.

<sup>20</sup> **Shënim:** Në Poezinë klasike japoneze, *qyqja* (*Hototogisu*) është simbol i melankolisë së një shpirti të vrarë, i cili, me qarjen e tij të trishtë, kërkon të kthehet në tokën e të dashurve.

<sup>21</sup> Frederik Rreshpja, *Zëri i Rinisë*, Tiranë, 25 nëntor 1992.

Ndoshta prej jetës së trazuar që pati, a prej muzës së melankolisë që i fërfëllinte në vesh, deri në fundin e jetës së vet ai mbeti një poet i trishtë. Madje edhe dy botimet e tij të fundit i pagëzoi me emrin e “Vetmisë”.<sup>22</sup> Por në thelb ama, mbeti një poet! Robert Elsie do ta pagëzonte si “një poet tronditës”. Tashmë, një tjetër kohë kishte ardhur dhe bashkë me të një Rreshpe edhe më i maturuar poetikisht. Siç i pëshpëriste vetes ndërsa ecte përgjatë bregut të lumit Herakliti i Efesit: “*Ne nuk mund të lahemi dy herë në të njëjtin lumë*”, edhe rapsodi i ri i pas ‘90-s nuk mund të ishte më ai bardi i vjetër i ‘68-’74-ës. Dhe kthesa estetike nuk do të vononte të vinte. Ajo do të mbante emrin “Erdhi ora të vdes përsëri”, një botim poetik i vitit 1994. Përsosja e formës poetike ishte një ëndërr dhe shqetësim i kahershëm për unin rreshpjan. Duket se këtë ëndërr të lashtë dhe kërkesën për bukuri artistike ai e mishëron tek “Erdhi ora të vdes përsëri”.

Në këtë vëllim poetik, poezia rreshpjane del nga korniza ideologjike dhe formalizmi i ‘68-’74-ës dhe fiton një tjetër përmasë dhe të tjera karakteristika. Ajo bëhet më tepër shprehëse, përfytyruese, surreale dhe avangardiste. Ndihet një gjallërim estetik i fuqishëm, natyra fiton një funksion të gjerë shprehës në varg, duke i dhënë atij një karakter të theksuar imazhinist dhe lirizmi bëhet kulmues. Me këtë vëllim poetik Rreshpja do të arrijë “*përsosjen e përgjimit të vetes.*”<sup>23</sup> Ky lirizëm, i cili do të ketë nota të thella trishtimi, nuk do të na ndahet. Në vargun e parë të poezisë së parë të këtij libri, vetë Rreshpja do të na paralajmërojë: “*Në atë shteg ku kaloj unë e ka kasollen vjeshta*”<sup>24</sup>, shteg të cilin e rrahu shpesh në jetë. Duket se Rreshpja bën pjesë në atë grup poetësh në të cilët futet dhe Lorika, të cilët e shohin poezinë “*si përpjekje stërmunduese dhe të dhimbshme për të nxjerrë ujin e dliër nga Zamzami i thellë i Zotit!*” Të lexojmë sesi shprehet esencialisht Lorika në poezinë “Udhëkryq:”

*“Çfarë dhimbje qenka  
Dhimbja e lashtë e poezisë,*

<sup>22</sup> **Shënim:** Dy librat e fundit poetikë të Rreshpjes: “*Vetmi*” dhe “*Në vetmi*”, 2004 Në vitin 2006, Rreshpja do të dilte nga ky labirint dhe do t’i rikthehej qiellit.

<sup>23</sup> Bloom, *Si dhe përse*, f. 91.

<sup>24</sup> Frederik Rreshpja, *Erdhi ora të vdes përsëri*, Lirika, “Albin”, Tiranë, 1994, f. 7.

*Kjo dhimbje ngulmuese  
Ka q larg nga uji i dliirë*".<sup>25</sup>

Poezia rreshpjane në kumt na ngjason paksa me poezinë klasike japoneze e cila është e trishtuar dhe ka në bazën e saj parimin estetik të quajtur "sabi", kuptimi i parë i të cilës si fjalë është "trishtimi i vetmisë".<sup>26</sup>

*"Ashtu si në këtë lloj poezie, edhe Rreshpja përdor imazhe të pazakonta apo subjekte me intencion të qartë që të tërheqë vëmendjen e lexuesit. Këto imazhe që ndërtohen mbi disa fjalë-çelës janë transparente dhe bëjnë të mundur për lexuesin që të shohë përmes fjalëve të poezisë emocionin që kërkon të evokohet".<sup>27</sup>*

*"Sipas ekspertit të poezisë klasike japoneze Donald Keene duke filluar me poezinë klasike "Waka" stinëve filloi t'ju kushtoj një interes i veçantë. Ato mund të përshkruheshin direkt ose përmes disa fenomeneve karakteristike siç janë p.sh.: mjegulla, vesa, perdet e tymit, errësimi i qiellit etj. Me kalimin e kohës disa fjalë stinore nisën të bëheshin arbitrare dhe të përsëriteshin në çdo krijim poetik siç është "hëna vjeshtake" p.sh., kur drita e saj në këtë stinë vlerësohet më tepër. Me tanka-n, dhe haikun më vonë përdorimi i këtyre fjalëve jo vetëm u bë thjesht i dëshirueshëm, por qe absolutisht esencial".<sup>28</sup>*

Kjo dukuri vihet re edhe te Rreshpja. Ai merr fjalë të tilla çelës që janë tipike për ligjërimin poetik klasik japonez, siç janë p.sh.: hëna, vjeshta, shelgu, bora, shiu, zogjtë, pisha, mali etj. dhe mbi bazën e tyre ngre gjithë pasqyrën treguese të poezisë, për reflektimin e brendësisë së vet emocionale. Madje këto fjalë në poezi ai i shpërndan dhe i përsërit shpesh. Rreshpja gjithashtu shkruan edhe me stilin e poezisë klasike japoneze që mbështeten

<sup>25</sup> Federico Garcia Lorca, *Poezi*, përktheu: Anton Papeleka, "Ekstra", Tiranë, 1999, f. 47.

<sup>26</sup> *Antologji e poezisë japoneze*, ribotim, përktheu: Petraq Kolevica "Dudaj", Tiranë, 2001, f. 14.

<sup>27</sup> Donald Keene, *The Pleasures of Japanese Literature*, Columbia University Press, New York, 1988, f. 42.

<sup>28</sup> Keene, *The Pleasures of Japanese...*, f. 38-39.

te tanka dhe haiku. Ja 2 shembuj për ta ilustruar këtë. Le të marrim së pari poezinë “Vizatim”:

*“Drurët si antena ku zërat kanë vdekur.  
Zogjtë tani e kanë shtëpinë tek era.  
U harrua hëna në kujtesën e gjetheve.  
Rrëzohet çdo ditë  
Nga mollët vjeshta”.*<sup>29</sup>

Në poezinë tjetër “Dhembje” shohim në korelacion dhe të ndërfaqur brenda strukturës poetike haikun:

*“Ngjitet malli nëpër rrënjë dhe bëhet lule.  
O druri i qershisë që të mbolli nëna ime-  
Unë jam vëllai yt”.*<sup>30</sup>

Një tjetër poet prej të cilit Rreshpja ndikohet ndjeshëm në këtë fazë krijimtarie është edhe adashi i tij Federiko Garcia Lorca (Federico Garcia Lorca). Njëri i këndoi Shkodrës së dashur, ndërsa tjetri Andaluzisë krenare. Njëri me instrumentin-simbol të shqiptarëve, lahutën, ndërsa tjetri me atë të spanjollëve, kitarën. Çuditërisht, lirizmi i tyre (po huazoj këtu shkrimtarin dhe kritikun italian Giovanni Mariotti) që *“një magjepsje e menjëhershme në një sfond të errët”*<sup>31</sup> Në një ligjëratë të mbajtur në vitin 1922, Lorca do të shprehet:

*“Ninullat, përrallat, legjendat, këngët, romanat dhe baladat - ato ma ngjallën shpirtin e poetit”*<sup>32</sup>.

Pra, fëmijëria del si burim kryesor përthithjeje dhe frymëzimi. Pjesën më të madhe të tyre i dëgjojmë dhe mëkohemi me to në këtë pjesë të jetës tonë. Një gjë e tillë ndodh edhe me Rreshpen. Siç e thekson studiuesi Moikom Zeqo për Rreshpen, *“Fëmijëria është*

<sup>29</sup> Frederik Rreshpja, *Lirika të zgjedhura*, “Evropa”, Tiranë, 1996, f. 15.

<sup>30</sup> Frederik Rreshpja, *Erdhi ora*, f. 68.

<sup>31</sup> Federiko Garcia Lorca, *Poezi*, përktheu: Fasli Haliti, “Ombra GVG”, Tiranë, 2005, f. 9.

<sup>32</sup> Grup autorësh, *Ese dhe shkrime të tjera kritike*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1986, f. 352.

një përrallë e shumfishtë - atdheu i imazheve”<sup>33</sup>. Ky atdhe imazhesh theksohet qartë në vargun rreshpjan:

*“Luanët e thyer të fëmijënisë pinë ujë tek pusi i vjetër”*.<sup>34</sup>

Ajo së bashku me djalërinë ndërfiten shpesh në varg dhe zënë një vend të gjerë në këtë vëllimth poetik. Poezia e Rreshpes po ashtu si edhe ajo e Lorkës është e prekur nga malli për këtë të kaluar (fëmijëria), melankolia, trishtimi, dashuria e munguar, ankthi për qenien, ëndërrimet dhe vdekja. Këto tema janë dhe lajtmotive për shumë poezi të tyre. Te Rreshpja vihet re një ndikim prej unit lorkian në të paktën 3 aspekte kryesore. E para prej tyre është ngjashmëria e habitshme në ndërtimin e metaforave. Tek “Erdhi ora të vdes përsëri” ne kemi shkëputur disa prej tyre, siç janë p.sh.: “Koka e trimit në dhëmbët e erës” (f.11), “Shpirti hënës kullon yje si tehe çeliku” (f.31), “Thika e trishtimit diku përdhe do të më lërë” (f.17), “Ëndrra e kaut të zi vërtitej mbi duna” (f.11), “Zëri im fytyrë ra në duart e tua” (f.27), “Kurbatka e vogël sapo vizatoi gojën e të dashurit të hëna e fëmijërisë” (f.37), “Kali i zi i pikëllimit”, etj. (“Lirika të zgjedhura”, f.57).

Për dikë që e njih mirë ligjërimin poetik lorkian, këto metafora do t’i tërhiqnin menjëherë vëmendjen dhe do ta dërgonin direkt te mjeshtri spanjoll. Një aspekt i dytë është tematika cigane, një temë kjo disi e parratur poetikisht në vendin tonë. Lorka vetë, në një ligjëratë të mbajtur për këngën popullore andaluze, në vitin 1935, midis të tjerash duke cituar muzikantin spanjoll Manuel de Falja thoshte:

*“Tri ngjarje historike, në shkallë të ndryshme, por mjaft fuqishëm, ndikuan në këngët tona: futja e këngës liturgjike në kishën katolike, pushtimi arab dhe të dukurit në Spanjë e kampeve cigane. Pikërisht ciganët - një popull i çuditshëm endacak - përcaktuan edhe trajtën përfundimtare të Cante Hondos\* sonë”*.<sup>35</sup>

<sup>33</sup> Moikom Zeqo, *Paradokset e demokracisë*, Publicistikë, “Evropa”, Tiranë, 1994, f. 160.

<sup>34</sup> Frederik Rreshpja, *Erdhi ora*, f. 16.

<sup>35</sup> Grup autorësh, *Ese dhe shkrime të tjera kritike*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1986, f. 372-373.

\**Cante Hondo* (spanjisht) - Fjalë për fjalë: “Këngë e thellë”. *Sigiriya* (Ciganishtja) është më tipikja prej tyre.

\**Selena* (greqisht) - Hëna. Në mitologjinë greke portretizohej si një vajzë e

Këtë ndikim të huazuar prej këtyre melodive cigane, Lorka e shpalos hapur në dy përmbledhjet e veta poetike "Poema e këngës së thellë (1922-1928) dhe "Romancë cigane" (1928). Në to, ai e merr figurën e përlulur por të lirë dhe lirik të ciganit endacak dhe e shndërron atë estetikisht në një simbol universal të njeriut që vuan. Pikërisht këtë parfum estetik thith dhe shpërhap në disa prej poezive të tij edhe Rreshpja ynë. Këtu është me vend të përmendim si shembuj poezitë: "Lërmë të vij tek ty", "Këngë kurbate", "Stuhi", "Vijnë ciganët" etj. Ndërsa aspekti i tretë lidhet me dashurinë selenike\* dhe përsëritjen e vargut për ta kthyer atë në refren melodie. Në poezitë e Lorkës hëna zë një vend të veçantë dhe qëndror. I dashuruar pas saj, ai jo vetëm që e ndërftoi atë shpesh në poezi, por ndërton madje me këtë element soditjeje poetike edhe një bollëk metaforash, duke krijuar kështu edhe një lojë të shumëfishtë poetike. Ajo mund të bëhet

*"mjaltë që kullon prej yjeve të vdekur", "pellg kur vijnë të pinë ujë yjet", "trup i akullt që varet në një majë prej letre", "luleshqerrë që përhap të ftohtin parfum", "ëndërr me gjakun e saj", "mbështetëse për shkallën ku ngjitet vetmia", "kalë resh qetësie" etj.<sup>36</sup>*

Këtë e konfirmon edhe vetë Lorka përmes një vargu poetik:

*"Dhimbja ime spirale, e ka zhbiruar hënën" <sup>37</sup>.*

Një selenofili të fortë dhe zhbirim të tillë poetik me hënën ka edhe Rreshpja. Nëse marrim për shqyrtim vëllimet poetike rreshpjane si: "Erdhi ora të vdes përsëri", "Lirika të zgjedhura" dhe "Vetmi", kjo fjalë përdoret poetikisht dhe shërben për të ndërtuar metafora gati 100 herë. Në verbin poetik rreshpjan ajo bëhet

*"fëmijë i pikëlluar reve që shkel mbi degët e shirave", "varkë dhimbje që çan qiellin nëpër mjegull", "shkallë drite mbi gremina", "forcë drite që shkallmon kullën e hijeve", "fener që shuhet në pëllëmbët e gjetheve", "qiri i natës që pikon*

bukur e leshverdhë, por me fytyrë të hequr e të zbehtë. Dashuri selenike, këtu ka kuptimin dashuri dhe fiksion pas hënës, si objekt soditjeje estetike.

<sup>36</sup> **Shënim:** Për më tepër shembuj të tillë, të shihen vëllimet poetike lorkiane, të përkthyer në shqip nga Anton Papeka, Visar Zhiti dhe Fasli Haliti.

<sup>37</sup> Federico Garcia Lorca, *Poezi*, f. 14.

*magji pellgjeve”, “vizatuese urash për ëndërra yjesh” etj.*

Si një studiues edhe i muzikës popullore andaluze, Lorca shfaq një karakteristikë tipike në poezinë e vet; ai e ndërton poezinë si këngë, me ritëm të brendshëm, lëvizje të shpejta, variacione dhe muzikalitet. Për ta ruajtur koherent këtë muzikalitet, ai zhvillon shpesh përsëritjen e një vargu apo distiku në formën e një refreni. Siç thekson edhe shkrimtari dhe kritiku italian Mariotti

*“këto vargje të përsëritur - këto refrene si çekanë, absolutisht kaq të thjeshtë dhe të shtruar bëjnë që lexuesi të mos humbasë në pyllin e imazheve dhe të metaforave. Funksionojnë në një farë mënyre, nga didaktika. Është ky ekuilibër prej të cilit varet besoj edhe suksesi popullor i Lorkës në Spanjë dhe diku gjetkë”<sup>38</sup>.*

Le të marrim një poezi nga Lorca dhe ta krahasojmë atë me një poezi rreshpjane. Më poshtë poezia dedikuar “Margarita Xirgut”:

*“Nëse iki, të dua edhe më  
kur jam, po aq të dua.  
Zemra jote është shtëpia ime  
dhe zemra ime - i yti kopësht.*

Unë kam katër pëllumba,

*katër pëllumbesha unë kam.  
Zemra ime është shtëpia jote  
dhe zemra jote - i imi kopësht”<sup>39</sup>.*

Ta vëmë përballë tani me poezinë e Rreshpes “Shtegëtar”:

*“Hënë s’ka, yje s’ka  
Ecën vetmia me bijtë e saj.  
Asnjëri s’më pret te porta, vetëm trishtimi  
Dhe trëndafilat tërë ankth.  
Nata dremit tek ajri i dritares.  
Ku janë gdhëndur sytë e mi në moment pikëllimi.  
Hënë s’ka, yje s’ka.  
Ecën vetmia me bijtë e saj”<sup>40</sup>.*

<sup>38</sup> Federico Garcia Lorca, *Poezi*, f. 17.

<sup>39</sup> Federico Garcia Lorca, *Poezi*, përkthet: Visar Zhiti, “Toena”, Tiranë, 1999, f. 34.

<sup>40</sup> Frederik Rreshpja, *Lirika*, f. 22.

A nuk është i njëjti efekt si në poezinë e mësipërme lorkiane?! Këtë efekt Rreshpja e eksperimenton në disa poezi duke përfshirë edhe atë që i jep titullin vëllimit, “Erdhi ora të vdes përsëri”. Ky kontakt me këtë poet bashkëkohor jo vetëm që do të ndikojë mbi krijimtarinë rreshpjane, por gjithashtu do ta ndihmojë atë që të kalojë në realizimin e asaj poezie që T.S.Eliot e ka pagëzuar si “*ndjeshmëria e unifikuar*”, e cila nuk është gjë tjetër veçse ajo lloj poezie e re e cila përftohet nga distilimi i mbresës dhe ndikimit. Sepse tek e fundit

*“poet i madh nuk është ai që duket apo mundohet të shfaqet si tejet personal, vetjak, por ai që grumbullon numrin më të madh të përvojave të lindura nga ai vetë ose nga të tjerët”.*<sup>41</sup>

Diçka të cilën ai e arriti në mënyrë mjeshtërore.

*“Artisti i vërtetë është thirrur në këtë botë për t’i kënduar bukurisë së shpirtit njerëzor, mirësisë dhe tronditjeve të tij”.*<sup>42</sup>

Dhe Rreshpja që ai beng shtegëtar i cili edhe pse migroi njëherë e përgjithmonë larg nesh, na la pas këngën e tij, atë këngë të thellë e të trishtë e cila na trondit si qenie shtegtare, ndërsa e ngre atë lart si një prej lirikëve tanë më të mirë bashkëkohorë.

### **Bibliografia:**

- *Antologji e poezisë japoneze*, ribotim, përktheu: Kolevica. Petraq, “Dudaj”, Tiranë, 2001.
- Belinski, G.V., *Artikuj kritikë*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977.
- Bloom. Harold, *Si dhe përse të lexojmë*, përktheu: Albana Sala, “Dudaj”, Tiranë, 2008.
- Grup autorësh, *Ese dhe shkrime të tjera kritike*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1986.

<sup>41</sup> Ilir Yzeiri, *Poetika nga Aristoteli tek Natali Sarrot*, “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2000, f. 99.

<sup>42</sup> Frederik Rreshpja, *Duke kërkuar Itakën. Poezi 1960-2006*, përmbledhi: Sokol Zekaj, “Princi”, Tiranë, 2016, f. 312.

- Keene. Donald, *The Pleasures of Japanese Literature*, Columbia University Press, New York, 1988.
- Lorka. G.Federiko, *Ballkon i hapur*, përktheu: Visar Zhiti, "Toena", Tiranë, 1999.
- Lorka. G.Federiko, *Poezi*, përktheu: Anton Papeleka, "Extra", Tiranë, 1999.
- Lorka. G.Federiko, *Poezi*, përktheu: Faslli Haliti, "Ombra GVG", Tiranë, 2005.
- *Poezi klasike kineze. Dinastia Tang*, përktheu: Ismail Kadare, "Naim Frashëri", Tiranë, 1961.
- Reshpja. Frederik, *Rapsodi shqiptare, "8 Nëndori"*, Tiranë, 1968.
- Ricks. Christopher, *Poems and Critics, "Collins"*, London, 1966.
- Ricos. Janis, *Mëhallat e botës*, përktheu: Spiro Çomora, "Naim Frashëri", Tiranë, 1961.
- Roncoroni. Federico, *Guida all analisi delle opera e degli autori nel loro tempo, "Arnoldo Mondadori"*, Milano, 1984.
- Rreshpja. Frederik, *Erdhi ora të vdes përsëri, Lirika, "Albin"*, Tiranë, 1994.
- Rreshpja. Frederik, *Lirika të zgjedhura, "Evropa"*, Tiranë, 1996.
- Rreshpja. Frederik, *Duke kërkuar Itakën. Poezi të zgjedhura 1960-2006*, i mblodhi: Sokol Zekaj, "Princi", Tiranë, 2016.
- Wegner. Hart, *Lamtumirë fjalë, Eseistikë*, përktheu: Pirro Dollani, "Ideart", Tiranë, 2006.
- Yzeiri. Ilir, *Poetika nga Aristoteli te Natali Sarrot, "Gjergj Fishta"*, Tiranë, 2000.
- Zeqo. Moikom, *Paradokset e demokracisë, Publicistikë, "Evropa"*, Tiranë, 1994.